

Procesverbal

Nga Mbledhja II (e dytë) e rregullt për vitin 2026 e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë: 26.02.2026

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti Vjetor Financiar për vitin 2025;
3. Propozimvendim për formimin e Komisionit për Udhëheqjen dhe Koordinimin e Punës në Terren për Zgjedhjet e Këshillave Lokalë;
4. Propozimvendim për themelimin e Mekanizmit Koordinues Lokal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore;
5. Propozimvendim për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës;
6. Miratimi i Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2026-2028;
7. Propozimi i dy delegatëve të Kuvendit të Komunës së Dragashit për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës; dhe
8. Eventuale.

Resul Fetahu: Të nderuar të pranishëm, mirë se erdhët në seancën e dytë të rregullt për vitin 2026! Meqë jemi në fillim të muajit të shenjtë të Ramazanit, dhe jemi në ditë të reflektimit, solidaritetit dhe përkushtimit shpirtëror, më lejoni që të ju uroj nga zemra këtë muaj të bekuar, me shëndet, paqe dhe begati për ju dhe familjet tuaja. Fillojmë me seancë, besoj se materialin e keni pranuar të gjithë me kohë. Në rendin e ditës i kemi shtatë pika, si dhe pikën eventuale. Nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën lidhur me rendin e ditës, urdhëroni! Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 21 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Raporti Vjetor Financiar për vitin 2025. A dëshiron dikush me e marrë fjalën?

Usmen Baldzi: Faleminderit kryesues, faleminderit kryetar i Kuvendit. Përshëndetje dhe selam për të gjithë të pranishmit, për kryetarin e komunës dhe për të gjitha mediat, si dhe përfaqësuesit e OSCE që janë të pranishëm në sallë. Edhe unë i bashkohem urimeve për Ramazan, mes nesh që jemi këtu të pranishëm nga e njëjta konfesion, për të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit dhe për të gjithë muslimanët në mbarë botën. Duke pasur parasysh se, siç thamë, është Ramazan

dhe kemi shumë pika të rendit të ditës, unë do të propozoja, kryetar, që disa prej tyre që nuk kanë të bëjnë me ligje, më falni, me data apo afate, nëse ka të tilla në rendin e ditës, t'i lëmë për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, ndërsa sot në rendin e ditës të mbajmë vetëm ato që janë të domosdoshme. Unë u paraqita për ndryshimin e rendit të ditës, por ju nuk më patë dhe doli sikur votova menjëherë, por nuk është problem as kjo. Nëse pajtoheni, natyrisht të gjithë, nëse jo, edhe kjo është në rregull dhe do të vazhdojmë më tej. Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, duke pasur parasysh se në mars na presin raportet për planet dhe punët e drejtorive dhe të organeve komunale, jam i mendimit se as kjo pikë sot nuk na merr shumë kohë, megjithëse ka shumë gjëra për të thënë dhe diskutuar. Unë do të flas vetëm në mënyrë sintetike, pa hyrë në analizë të detajuar, lidhur me subvencionet. Është shkruar vetëm në mënyrë narrative se komuna, me vullnet të mirë, ka ndarë subvencione për disa organizata joqeveritare, kryesisht, siç po e shoh. Nuk do të flas për subvencionet për trajtim mjekësor, sepse ato jepen në bazë të sëmundjes, por subvencionet për organizatat joqeveritare janë vetëm të listuara në mënyrë narrative. Nuk mendoj se kjo është në rregull dhe nuk mendoj se buxheti ynë do të duket mirë kur dikush që merret me buxhete të shohë se gjithçka është vetëm e përshkruar në mënyrë narrative, sepse do të pyesë se ku janë shpenzuar ato mjete. Do të kërkoja nga raportuesi i kësaj pike të rendit të ditës, drejtori i Drejtorisë së Financave, që në raportet e marsit të na paraqesë për të gjitha organizatat joqeveritare një përlllogaritje të shpenzimeve të buxhetit që kanë marrë nga Komuna e Dragashit, pra nga buxheti i qytetarëve të Komunës së Dragashit – si, ku dhe cilat aktivitete kanë realizuar dhe si e kanë shpenzuar atë buxhet. Ky është një kërkesë legjitime brenda ligjit, në mënyrë që të mos kemi probleme me Agjencinë Kundër Korrupsionit në Kosovë apo me departamente të tjera që merren me këto çështje. Së dyti, e përsëris, sa i përket subvencioneve, në të ardhmen duhet të kemi kujdes – nuk mund të japim subvencione nëse bëhet fjalë për konflikt interesi. Në organizatat joqeveritare në pjesën e Gorës kemi organizata ku anëtarët e tyre janë – as më pak e as më shumë – drejtorët tuaj ose drejtori juaj. Nuk dua, meqë është Ramazan, të hyj në një demaskim të plotë të kësaj çështjeje, por dihet për kë bëhet fjalë dhe ata do ta njohin veten. Bëhet fjalë për “Stars”, ndërsa vëllai i tij është te “Milina”. Pra, kjo është një konflikt klasik interesi dhe ju lutem – nuk po e fajësoj kryetarin e komunës, nuk besoj se ai apo Komiteti për Financa dhe Politikë nuk e kanë ditur apo nuk i njohin anëtarët e këtyre shoqatave, por kjo është përgjegjësia e tyre; ata është dashur të tregojnë për kë bëhet fjalë. Për aktivitetet as që po flas. Ka disa gjëra që nuk janë realizuar, por tani nuk do të hyj në këtë. Prandaj propozoj dhe i lutem Kuvendit që kjo të jetë sa më e shkurtër, në mënyrë që për shkak të Ramazanit ta përfundojmë sa më shpejt këtë seancë. Dhe në fund, ndoshta drejtori, kur të marrë fjalën, do të shpjegojë nëse është respektuar shpërndarja e drejtë dhe e barabartë e buxhetit në Komunën e Dragashit, duke pasur parasysh se sipas regjistrimit të fundit të popullsisë 39% janë komunitete joshumicë, ndërsa sipas regjistrimit paraprak 41,3%, sipas informacioneve të publikuara. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Gjithashtu, a është përmbushur parimi i përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë në organin e administratës, në kuadër të punësimit? Unë e di që nuk është. Ka aq pak punëtorë nga komunitetet joshumicë në organin e administratës në Dragash sa mund t'i përmend tani me emër. Njerëzit kanë dalë në pension, ishte pandemia, por në vitet e fundit – tre, katër apo

pesë, nuk ka rëndësi periudha – është pranuar një numër i madh punëtorësh nga komuniteti shumicë, ndërsa vetëm një nga komunitetet joshumicë, dhe mund t'ju them saktësisht se kush është. Pra, po flas për organin e administratës. Nuk po flas për Drejtorinë e Shëndetësisë apo për Drejtorinë e Arsimit. Ju lutem që edhe kjo të përfshihet në këto raporte dhe të kontribuojmë në një klimë pozitive në komunë, duke pasur parasysh se është Ramazan dhe që edhe diskutimet tona duhet të jenë në atë frymë. Faleminderit.

Granit Rifaj: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pasi e bënë mos me e zgjat, edhe unë do të mundohem me qenë pak më i shkurtë. I kam do pyetje të shkurta, qetu shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit kanë rritje. Është një kod – shpenzimet këshilldhënëse dhe profesionale – nëse ka mundësi me na shpjegue çka është me këtë kodin. Pastaj po dal te këto projektet kapitale: 49403 e ka kodin, hapja e kanalit dhe rregullimi i ulëseve dhe trotuarit në Kosavë. Aty ka njerëz që kalojnë më shpesh se unë, kurrfarë punë, kurrfarë kualiteti nuk u bë, plus qato ulëset unë nuk i kam pa kërkund. Me pyet, a kanë me u bo, se këto ishin pague, qysh po e shoh. Masnej, me pyet për qeta stadionat: ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaç, 70 mijë euro, edhe një kohë ka qenë për njëfarë urgjence 50 mijë euro, që po i bjer se u dashtë me u krye ai stadioni, atje në vend nuk po doken punët. Ndërtimi i stadionit në Kreveqicë, në Pllavë, 50 mijë euro, çka u bo aty? Qytetarët po luajnë hajgare, njëfarë bazeni olimpik po e presin, kur ia keni nis. Edhe qetu nuk e kam të qartë: Kubëzimi i rrugëve në rrugët “Luftëtarët e Lirisë”? Rrugë në rrugë, nashta unë jam gabim, nuk po e di, në qoftë se ka mundësi një sqarim. Edhe te ndërtimi i rrugës Kukajan-Dragash, 40 mijë euro, nuk po i shohin qytetarët ku janë, a ka mundësi me na kallxue dikush.

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Të nderuar delegatë, Raporti Vjetor Financiar është një raport që jepet çdo fundvit. Janë transaksione ekonomike të cilat kana ndodhë dhe paraqiten në këto pasqyra në fund të vitit. Këto njëkohësisht harmonizohen me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, para se të vijnë në Kuvend për miratim. Të gjitha këto transaksione i kanë kaluar filtrat të cilat janë të parapara që të vijnë si dokumentacion për shqyrtim në këtë Kuvend. Ju e keni marrë me kohë dhe keni pas mundësi që ta analizoni po të njëjtin raport financiar të cilin sot po e debatojmë. Mirëpo, sa u përket subvencioneve dhe ndarjeve, janë çështje subjektive që ky raport nuk e precizon se kujt i ndahen dhe kujt nuk i ndahen. Dihet se subvencionet e OJQ-ve ndahen në drejtorate të cilat janë përkatëse për një lloj veprimtarie. Në këtë rast kemi të bëjmë me aktivitete kulturore të cilat ndahen përmes komisionit të cilin e përcakton DKRS-ja. Këto OJQ paraprakisht i përmbushin kriteret për aplikim të cilat janë të vendosura me thirrje publike, për të kryer aktivitete të cilat ka nevojë Komuna, ose në këtë rast DKRS-ja. Tash, subjektivizmin ky raport nuk e shpjegon, ky raport shpjegon se këto shpenzime janë krye në kohë dhe vlera e atyre shpenzimeve është kaq. Mendoj se, përpos këtyre, në mesin e të gjitha lëndëve për auditim të jashtëm është edhe lënda e subvencioneve e cila e ka kaluar fazën e auditimit të jashtëm dhe realisht nuk kemi vërejtje. Tash, ju si delegatë mund të jepni mendimet e juaja të lira dhe ne do të jemi të kënaqur t'i mirëpresim ato. Por në fakt, filtrat të cilat është paraparë që t'i kalojë ky raport financiar, i ka kalue dhe ka ardhë këtu në Kuvend, vetëm e kërkon miratimin tuaj që të vazhdojmë punë më tutje. Sa i përket ndarjes së buxhetit Fair Play, ne disa vjet me radhë, prej se kemi ardhur në qeveri, me vullnetin e kryetarit dhe në bashkëpunim me të gjitha subjektet politike, qoftë edhe komunitetit

goran, paraprakisht bëjmë ndarjen e buxhetit në 41% për komunitete. Por në të shumtën e rasteve, e kemi të favorizuar komunitetin goran, për faktin se kemi edhe donacione tjera të jashtme dhe kemi edhe investime me bashkëfinancim me donatorët, dhe kur e nxjerrim rezultatin përfundimtar, del se ka investime bukur me shumë aty. Mirëpo, ka raste kur i përdorim mjetet financiare për një investim kapital dhe na mungojnë, mund të marrim prej një komuniteti te një komunitet tjetër. Në qoftë se i marrish raportet e fundit të cilat i kemi pas – e që delegati Usemn Baldzi është i ri dhe nuk ka pas rastin t’i dëgjojë në këtë Kuvend – se Komunë e Dragashit, pikërisht nga DEMOS, për ndarjen Fair Play ka marrë një mirënjohje dhe jemi në mesin e katër komunave më të mira për ekzekutim të projekteve të cilat i kemi realizue në Komunën e Dragashit. Sa i përket pyetjes së Granitit, ishin pak a shumë pyetje me vend, mirëpo jo të drejtuar për këtë raport. Sa i përket kanalizimit, se a jemi të kënaqur me punimet, shpeshherë nuk është i kënaqur as kryetari e as na. Për faktin se operatorët ekonomikë jo gjithmonë i kryejnë punët sipas kërkesave dhe qëllimeve tona. Ka disa raste që s’po jemi të kënaqur askush, mirëpo në përgjithësi punët janë krye dhe do të kryhen edhe ato pjesë të cilat kanë ra në sy, ose kanë nevojë për përmirësime, do të përmirësohen gjatë këtij viti. Sa i përket stadiumeve, të gjitha mjetet të cilat kanë qenë të planifikuara për vitin 2025, janë kryer në terren. Në qoftë se keni ndonjë vërejtje, ju mund të shkoni edhe Të bisedoni me menaxherët e kontratave, ata mund t’ua shpjegojnë në aspektin teknik. Unë mund t’ju shpjegoj vetëm në aspektin financiar, sepse asnjë pagesë nuk mund të bëhet – edhe besoj që ti e dijshe ma mirë sesa unë – derisa nuk pranohet nga komisioni dhe nga menaxheri i kontratës. Prandaj, të gjitha këto mjete të cilat janë bart për këto projekte për të cilat ju flisni, unë mendoj që kemi raporte detale të cilat i kanë menaxherët e kontratave, dhe shumat të cilat ekzistojnë këtu janë shuma reale me punët të cilat janë bërë në terren.

Granit Rifaj: Veç për sqarim, se unë i di ato procedurat qysh shkojnë, pranimi nga komisioni e menaxheri, kur të kryhen punët unë e di, ekzekutohet pagesa. Në qoftë se punët ne po i shohim që nuk janë krye, unë nuk e di çka të ka nënshkruar komisioni edhe menaxheri i kontratës, punët nuk janë krye në terren, i ke pa edhe vetë, e pranove tërthorazi edhe vetë. Plus, në fshatin Blaç unë nuk di por në bazë të qytetarëve, nuk u punue aty hiç, 70 mijë euro janë pague. Këtë dashta me e ditë. Edhe rrugën Kukajan – Dragash, më doket harrove, edhe rrugët te rruga “Luftëtarët e Lirisë”, pyeta, se nuk e kam të qartë, në bazë të përshkrimit, nuk e di, nashta jeni në rregull. Në qoftë se bën, me ma sqarue!

Qamil Kolloni: Granit, po më vjen mirë, po i dhaje vetë përgjigje, thaje po folin qytetarët e fshatit Blaç. Unë nuk raportoj me atë çka folët, unë raportoj në bazë të shifrave dhe në bazë të raporteve. Raportet nga menaxherët të cilët kanë ardhë përputhen me pagesat të cilat janë bërë nga drejtorati. Dhe ‘rrugët nga rrugët’ është një rrugë kryesore që pastaj ndahet në disa rrugë dhe ato janë kubëzuar. Mirëpo, të gjitha këto punime janë pranue nga komisioni dhe menaxheri, dhe si të tilla janë paguar. Këto në përgjithësi, edhe për rrugën në Kukajan e njëjta është.

Usmen Baldzi: Kërkova të jemi më të shkurtër, kërkova të jemi në frymën e Ramazanit, por, drejtor, nëse këtu shkruan e planifikuar dhe e shpenzuar, Graniti ka të drejtë. Unë qëllimisht e

kam anashkaluar Kukljanin. Qëllimisht. Sepse po pres raportin që do të vijë në mars. Dhe është Ramazan. Nëse është planifikuar dhe shpenzuar, ne nuk po themi, drejtor i financave, se ju e keni planifikuar dhe ju personalisht e keni shpenzuar. Këtu nuk ka asgjë personale. Rruga Kukljan–Dragash është në buxhetin e Republikës së Kosovës, në investimet kapitale, dhe është paraparë që të fillojë – madje sipas informacioneve që kemi nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, tenderi këto ditë është përfunduar. A është këtu ndonjë gabim? Apo diçka tjetër? Këtë do ta shohim në mars. Ndërsa ju si drejtor – ne ju kuptojmë kur thoni e planifikuar dhe e shpenzuar. E kuptojmë që keni marrë raportet nga shfrytëzuesit e buxhetit për mjetet e planifikuara dhe të shpenzuara. Ju kuptojmë, drejtor i financave. Por edhe ju duhet të na kuptoni ne – në Komunën e Dragashit nuk kemi vetëm Drejtorinë e Financave. Për investimet kapitale dihet kush i shpenzon, si të themi. Dhe që të mos vazhdoj më tej – do të jem i shkurtër, sepse i kam lutur edhe të gjithë anëtarët të jemi të shkurtër. Por ju lutem, njerëz, mos më thoni vazhdimisht se flas shumë. Unë nuk jam zgjedhur nga qytetarët që të hesht. Kush është zgjedhur të heshtë – ai hesht. Ka marrë pozitën dhe nuk i intereson. Unë do të flas katër vjet, do të bashkëpunoj me ju, me qëllimin që Bexhet Xhemadini të jetë një kryetar i mirë i Komunës së Dragashit, sepse ai ka fituar zgjedhjet. Ne këtu ia kemi uruar. Dhe nuk bëjmë asgjë me qëllim tendencioz. Ai tani nuk është këtu, por gjithçka që themi është për të mirën e qytetarëve të Komunës së Dragashit. Edhe Graniti, edhe unë, edhe kushdo nga ju – kur kërkojmë diçka, nuk e kërkojmë për vete. Ndoshta duhet të fillojmë të mendojmë pak ndryshe? Të mos ndahemi në parti, në vota, se kush e mundi kë. Veçanërisht i lutem drejtorit të financave – drejtor, nëse 50.000 euro në Kukljan janë shpenzuar, atëherë do të kemi problem me Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Unë do t'u përgjigjem disa pyetjeve që i bënë parafolësit. Usmen Baldzi i përmendi subvencionet. Ne vitin e kaluar kemi ndarë subvencione për të gjitha OJQ-të të cilat kanë konkurrue nga regjioni i Gorës. Asnjë OJQ nuk e kemi eliminue nga përfitimi i subvencioneve. Në bazë të informatave që i kam unë, nuk ka pas asnjë OJQ e cila ka fitue thirrje publike, e që ka pas konflikt interesi. Ka pas thashetheme, po këto janë vërtetuar që nuk ka konflikt interesi. Ata të cilat mendojnë që ka pas ose ka konflikt interesi, mund të bëjnë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Gjithashtu, u tha se në muajin mars duhet të japin nga një raport të gjitha OJQ-të që kanë marrë subvencione, me i pa ku i kanë shpenzuar mjetet. Nëse dikush është i interesuar, këto OJQ-të që i kanë marrë nga Komuna, qysh i kanë shpenzuar, personi në fjalë mund të bëjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare vetë personalisht. A, përndryshe, ligji nuk e lejon me dalë këtu, para Asamblesë, edhe me ardhë ai me raportue ku i ka çue ato pare. Kështu që, në këtë drejtim, unë mendoj që do të jetë i kënaqur me përgjigjen që ia dhamë. Sa i përket stadionit në fshatin Blaç, është projekt trevjeçar, është duke u punuar, edhe vitin e kaluar janë paguar mjetet financiare në bazë të punimeve që janë bërë. Vazhdon edhe këtë vit ndërtimi i këtij stadioni, edhe pse është projekt trevjeçar, ka mundësi që ky stadion përfundon sivjet. Sa i përket rrugës te Kukajani, punimet janë kryer në tërësi dhe pagesa është bërë në vëllimin e punimeve që është bërë. Qato punime që janë kryer, është bërë pagesa. Nëse kanë mbet punime që nuk janë kryer dhe pagesa nuk është bërë, për këtë, nëse dikush do me e vërtetue, munden me e

vërtetue, ka forma të ndryshme me e vërtetue. Edhe stadiumi i Pllavës është projekt trevjeçar, vazhdon edhe këtë vit, edhe do të përfundojë. Arsyeja pse e kemi bërë është sepse nuk kemi pas mjete. Kemi mendue se do të na ndihmojë Ministria, nuk na ka ndihmue. Te fshati Blaç e di që e kemi pas një herë një donator i cili ka premtue. Ne Komuna e kemi bo atë pjesën që e kemi planifikuar me e bo, pjesën tjetër ka pas me e bo ai investitori, por ai tash e ka një krizë financiare edhe u tërheq. Kështu që, ne jemi detyruar prapë me shpallë tender që edhe stadionin e Blaçit me e ndreq me projekt trevjeçar, po ka mundësi, sipas të gjitha gjasave, që përfundon sivjet. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Unë sot nuk pata me dalë me diskutue për këtë temë, se me drejtorin edhe kryetarin në Komitet dje kemi harxhue bajagi kohë, por drejtori është shumë i mirë edhe nxit deba, është shumë politikan. Diskutimi i drejtorit ishte se edhe kryetari nuk është i kënaqur me punimet, dhe e hodhi topin te komisioni. Domethënë, kryetari edhe drejtori nuk kanë faj, Komisioni mbikëqyrës i ka fajet. Në vitin e parë, kryetari pat thënë fjalë të mira për këtë Drejtorinë e Urbanizmit dhe për këta komisionet vlerësues. I pata thënë qysh në fillim kryetarit, mos u ngut kryetar, se të njëjtit kanë qenë edhe drejtori, edhe komisionerët, edhe mbikëqyrësit, kanë qenë edhe të PDK-së, edhe të LDK-së, ata janë të njëjtit, huji është me shpirtin. Edhe jo ti, po me ardhë kush me ardhë, qata drejtorja edhe qata mbikëqyrësa e kanë marrë hovin prej PDK-së, janë duke vazhdue me ju. Pse në fillim pate thënë aty ka punime të mira, e tash drejtori po thotë nuk jeni të kënaqur me punimet. Nuk jeni, se aty pak po dyshoj që i kalojnë, ta bien vlerësimin, ju i bëni pagesat, ose e bëni pagesën edhe pa e krye punën. Dje e pata pyet drejtorin për një kod, ishte 988 euro, dhe ma shpjegoi se janë harxhuar për kafshët e egra. Unë po çuditem, 988 euro, me siguri është fjala për dy arusha në Bellobrad që dolën edhe që i keni qit ushqim qatyre dy arushave, me kushtue 1 mijë euro, po më vjen si shumë bre. Stadiumin e Blaçit, kryetar, tash e ndjeva që për tri vite do të kryhet. Unë sa e di matematikën, edhe në vitin e parë kur pate ardhë si kryetar i Komunës, i patëm ndarë 50 mijë euro urgjent për stadiumin e Blaçit. Katër vite shkuan, edhe tri vite sot, nuk janë tri vite, kryetar, po janë tre plus katër – dysh e kam pas në matematikë – shtatë vite një stadium s'un po e ndreqni.

Zgjim Fejza: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Duke e parë Raportin Financiar për vitin 2025, e shohim se në fshatin Kuklibeg investimet kapitale janë të ulëta, krahasuar me fshatrat tjerë. Siç shihet, për fshatin Kuklibeg janë planifikuar gjithsej 46,340 euro investime, ku projekti i ndriçimit publik me vlerë prej 30 mijë euro është realizuar, ndërsa projekti për kubëzimin dhe ndërtimin e kanalit për ujërat atmosferikë, me vlerë prej 16 mijë euro, nuk është realizuar. Do të doja një sqarim për mosrealizimin e këtij projekti dhe, a ekziston mundësia që këto mjete dhe ky projekt të bartet në vitin 2026, në mënyrë që projekti të realizohet dhe të mos humbasë investimi. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Përsëri, propozimi im është të presim deri në prill, pasi në mars do të kemi raportet e drejtorive dhe raportet e tyre. Do të kemi raportet e punës së të gjitha drejtorive të Komunës së Dragashit dhe të vetë komunës, nga kryetari i komunës deri te instancat më të ulëta. Atëherë do të shohim më shumë. Le ta marrë kjo shumicë qeverisëse këtë si propozime plotësuese, në mënyrë që në mars disa nga vërejtjet që kemi marrë nga ana e, le të themi,

opozitës – nëse duam të flasim politikisht – të sqarohen, të afrohen dhe të shpjegohen, por gjithmonë me qëllim që të mos kemi probleme. Drejtor, edhe në korridor ju thashë – ju jeni drejtor i financave. Për investimet kapitale këtu duhet të vijë zotëria që udhëheq Drejtorinë e Urbanizmit dhe Infrastrukturës dhe të japë shpjegime. Kryetari i komunës është një person i zgjedhur politikisht, një njeri që duhet të na udhëheqë të gjithëve këtu, por ai ka ardhur në këtë funksion në mënyrë politike. Ai ka emëruar drejtorët dhe këshilltarët përkatës, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhe ata duhet të paraqiten këtu dhe të na japin shpjegime. Sa i përket Kukljanit – 50.000 euro. Unë ju them, drejtor, nuk e di nëse paratë janë shpenzuar, por që diçka është bërë – nuk është bërë. Ka probleme edhe në Rapçë. Por po ju pres, e di, në mars. Unë jetoj në Gorë. Ndoshta e njoh më pak Opojën, por do të pyes edhe atje, sepse jam gjithmonë mes njerëzve. Nuk rri nëpër zyra dhe korridore të Komunës së Dragashit dhe nuk merrem me thashetheme. Unë kam ardhur këtu seriozisht të merrem me politikë. Nuk ka rëndësi që është kuvend lokal. Nuk munda në Prishtinë, sepse u ngopa nga puna në qeveri. Falë Zotit, tani jam në pension. Prisja, kryesues, që të më uronit – e kam lënë arsimin për shkak të një rregulloreje që e respektoj, në mënyrë që të merrem me politikë. Jam përcaktuar, ashtu si edhe kolegu im Samidin, për punë në Kuvend. Ka shumë gjëra. Është Ramazan, kemi thënë të jemi më të shkurtër. Prandaj i lus edhe opozitën që këto vërejtje që kemi dhënë të jenë propozim për marsin, kur do t'i shqyrtojmë në mënyrë të detajuar të gjitha shpenzimet nga buxheti i Komunës së Dragashit, përkatësisht nga buxheti i qytetarëve. Ka shumë vërejtje. Meqë është Ramazan, këtë pikë mund ta kalojmë, sepse rendi i ditës tashmë është miratuar, por mund ta miratojmë me vërejtje dhe të presim marsin. Kryetar, ju jeni kryetar – nuk pres që t'i dini të gjitha për Komunën e Dragashit. Ju jeni mjek me profesion, tani jeni politikan si të gjithë ne këtu. Por ne jemi anëtarë të Kuvendit dhe këtu merren vendimet. Shpesh thoni se nëse duam qasje zyrtare në dokumente, atëherë ta bëjmë kërkesën. Jo, ne jemi anëtarë të Kuvendit. Kjo është për qytetarët. Këtu merren të gjitha vendimet. Akti i themelimit të organizatës joqeveritare në Brod, që e përmenda – “Stars”. Nëse zotëria është anëtar, është; nëse nuk është, nuk është. Nëse gabo, kërkoj falje. Ky është Kuvendi, këtu duhet të flitet hapur. Unë mendoj se është, e di që është – dhe kjo është konflikt interesi. Dhe nuk po them se kryetari është fajtor apo Kuvendi. Ndoshta nuk e ka ditur. Askush nuk e di, sepse kur kërkohen subvencione nuk përmenden anëtarët, por kërkohet realizimi i projektit. Çfarë aktivitete ka realizuar “Stars”? Do ta shohim në mars. Këtu do të vijnë ata që i kanë ndarë subvencionet, kryetari do të shpjegojë. Çfarë kam unë me një organizatë joqeveritare? Unë flas në emër të qytetarëve. Të gjithë ne e dimë si qëndrojnë gjërat, por e gjithë kjo duhet të jetë e qartë dhe transparente. Të gjitha këto i them për të mirën e përgjithshme. Prandaj pyes – pse ta zvarrisim?

Bexhet Xheladini: Unë do t'i përgjigjem delegatit nga fshati Kuklibeg. Ndriçimi publik ka përfunduar, edhe pse ka qenë projekt dyvjeçar, ka përfunduar në vitin e parë. Ne i kemi kompanisë borxh mjete, ajo me mjetet e veta e ka krye projektin dyvjeçar, e ka krye për një vit. Ne mjetet i kemi të parapara, tash si të lëshohet buxheti, e bëjmë pagesën. Sa i përket kanalit të hapur, është bërë pagesa për punën e kryer. Për punën e cila ka mbet pa u kryer, ky projekt do të vazhdojë këtë vit dhe do të përfundojë. Ka qenë një problem aty, sepse në projekt ka qenë që deri në fund të

shkohet me kanal të hapur, por me kërkesë të fshatarëve, ata kanë kërkuar që një pjesë me qenë me gypa nëntokësorë. Kështu që, ne nuk kemi mund me e bo këtë konvertim, dhe sivjet kryehet edhe ajo pjesa që kë mbet pa u krye. Unë mendoj që kemi dhënë sqarime të mjaftueshme për këtë çështje, po ata të cilët dyshojnë që është bërë pagesa pa i krye punimet, thashë edhe një herë që ka forma dhe rrugë tjera me i ndjek. Por, tash e kemi edhe Raportin e Auditorit, i cili është duke e bërë auditimin e shpenzimeve të vitit 2025. Vjen raporti, nëse në atë raport Auditori gjen shkelje, ne mundemi këtu me i diskutue. Unë jam i sigurt që nuk është bërë asnjë pagesë pa i krye punimet. Granit Rifaj: Shumë shkurt, më nuk kam me folë për këtë temë, veç dashta me i thënë kryetarit se ne nuk po dyshojmë. Dyshimet që i patëm ne, na i vërtetoi drejtori paraprak edhe kryetari i Komunës, kur tha punëkryes të papërgjegjshëm, punime jokualitative. Qato punime që janë prezantue aty, këta edhe vetë e pranuan që nuk janë, edhe atëherë – për me e pastrue veten, se unë nuk kam kurgjo personale me asnjërin këtu, për me pastrue veten – këtu lypim me pas hetime prej organeve përgjegjëse. Kryetarit dashta një pyetje shumë ma konkrete: cilat punë janë krye në rrugën Dragash-Kukajan, se thajë që janë paguar qato punë që janë krye. Unë me sa e di, ishalla jam gabim, në rrugën Kukajan-Dragash asnjë punë nuk u krye. Faleminderit!

Uran Halimi: Përsëritet të gjithë! Deshta me u ndërlidh – edhe pse, në fakt, nuk lamë më kohë edhe fjalë për stadiumin e fshatit Blaç – nëse ka qenë projekt trevjeçar, ka shkue një mandat katërvjeçar, unë qysh e di, prej kohës kur ne kemi diskutue për stadiumin. Edhe, kemi trazue shumë pluhur, ka qenë me urgjencë, e në ndërkohë shumë stadione tjera janë nis e nashta edhe kryhen përpara stadiumit të Blaçit. Ju siguroj që përgjatë vitit 2025 nuk janë zhvilluar fare punime në atë stadium, edhe pse këtu po shohim që janë pague 70 mijë euro. 50 mijë janë pague në atë kohën kur na e kemi votue edhe e kemi miratue fillimin e punimeve për stadiumin e fshatit Blaç, ndërsa në vitin 2025 po e shoh që janë pague edhe 70 mijë euro pa u zhvillue asnjë punim, gjendja është e mjerueshme aty. Kam diskutue këtu në foltore edhe e kam shfaq gjendjen e stadiumit në Blaç, rrethojat janë gjysmë të rrënuara, edhe pse janë përfunduara pa u hap ai stadium, ato veç janë duke u rrënuar, ka pjesë të prishura për shkak të reshjeve aty. Deshta me e pyet kryetarin, te fshati Kukajan, na kalojmë aty pari: a janë investime 40 mijë euro brenda në fshat, apo? E, brenda në fshat, ta saktësojmë, se këtu Dragash-Kukajan është rruga kryesore. Nëse flasim për investime për rrugën Dragash-Kukajan, aty, ne të gjithë e dimë, veç dikush që nuk ka ec hiç aty nuk e di çka është fjala, po rruga Dragash-Kukajan është fare e painvestuar. Është në gjendje të mjerueshme, kryetar. Ndërsa, sa u përket investimeve brenda në fshat, ai është muhabet krejt tjetër. Te Kreveqica qenkan paguar edhe 50 mijë euro. Nëse paguhet 50 mijë euro për me shkatërrue edhe degradue natyrën, ky është modeli më i mirë i mundshëm. Faleminderit shumë!

Bexhet Xheladini: Është emri i projektit, dhe ne kemi ndarë mjete për rregullimin e rrugës Dragash-Kukajan. Nga Ministria e Infrastrukturës na kanë thënë se këto mjete që i keni nda ju – kjo rrugë është kompetencë e Ministrisë edhe këtë rrugë do ta bëjmë ne, edhe urën edhe rrugën. Edhe ne pastaj ato mjete i kemi orientue në fshatin Kukajan, kemi bërë investime. Por megjithatë, edhe pse na kanë thënë ata që do ta bëjmë këtë rrugë, prapë Ministria nuk e ka bo. Unë kam biseduar me Ministrinë disa herë, ata janë të gatshëm, më duket se kanë ndarë mjete prapë edhe sivjet, ka mundësi që e bëjnë. Na kanë thënë që duhet me bisedue me pronarët përreth rrugës, se

na rrugë nën katër metër nuk shtrojmë. E ka me ligj Ministria. Po aty kur ka dalë Komisioni e ka mat, në disa vende nuk është katër metër, po megjithatë ata në fund kanë pranue që do të investojnë edhe unë besoj që këtë vit Ministria ka me e ndreq këtë rrugë.

Resul Fetahu: Faleminderit! Besoj se diskutimet janë krye. Atëherë, e qesim në votim Raportin. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 16 vota për, zero kundër dhe 4 abstenime, miratohet Raporti Financiar. Vazhdojmë me pikën e tretë: Propozimvendim për formimin e Komisionit për Udhëheqjen dhe Koordinimin e Punës në Terren për Zgjedhjet e Këshillave Lokalë.

Bexhet Xheladini: Propozimvendimin e keni marrë, mos ta lexoj me humb kohë. Këtu janë edhe propozimet, LDK-ja duhet ta propozojë një anëtar, PDK-ja një, VV-ja një, JGP-ja një, dhe ekzekutivi ka me i propozue dy anëtarë. Unë, për mos me dalë edhe një herë, si kryetar i Komunës do t'i propozoj nga ekzekutivi që të jetë Fari Kolloni edhe Uzair Hamza. Kështu që, i kisha lut përfaqësuesit e partive politike të dalin dhe t'i propozojnë emrat. Faleminderit!

Shukri Myrtezani: GP i LDK-së e propozon Vezir Reshitin.

Zgjim Fejza: Nga GP i PDK-së e propozojmë Granit Rifajn.

Jetmir Ajdini: Nga GP i VV-së propozojmë Uran Halimin.

Ventaza Esati: Nga JGP propozojmë Danis Hodza.

Resul Fetahu: Faleminderit! Këtu i kemi gjashtë propozime, kurse anëtari shtatë, secili fshat do t'i japë propozimet e veta. Atëherë, emrat e propozuar janë: Vezir Reshiti, Granit Rifaj, Uran Halimi, Danis Hodza, Fari Kolloni dhe Uzair Hamza. E qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 18 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Propozimvendim për themelimin e Mekanizmit Koordinues Lokal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjimore.

Lindita Kozmaqi Piraj: Përshëndetje për të gjithë! Më lejoni që të kaloj mbi historikun, formën e themelimit të këtij mekanizmi dhe të funksionimit të deritashëm, për të kaluar më tej me atë çka kërkohet sot nga ju. Mekanizmi Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është themeluar në vitin 2013, me mbështetjen e organizatës ndërkombëtare UN Women, me anë të nënshkrimit të një memorandumit të mirëkuptimit midis kryetarit të atëhershëm, z.Salim Jonuzi, dhe të gjithë anëtarëve të tjerë përgjegjës. MKKDHF është themeluar me qëllim që të sigurojë një reagim të menjëhershëm, një koordinim gjithëpërfshirës dhe një reagim institucional për adresimin e rasteve të dhunës, dhe të kontribuojë në krijimin e politikave proaktive kundër dhunës në familje, në Komunën e Dragashit, ku ka vazhduar më tej për ripërtërirjen e nënshkrimit, me ardhjen e kryetarit tjetër me radhë, z.Shaban Shabani, për të vazhduar me kryetarin aktual, z.Bexhet Xheladini, në vitin 2022, me mbështetjen e OSBE-së. Mirëpo, me ndryshimin e Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjimore, në 2023-tën, këta mekanizma kanë hyrë në ligj. Si rrjedhojë e kësaj, sot e kemi një Rregullore të re me nr. 01/2025, ku obligon që këta mekanizma të themelohen me anë të një vendimi të nxjerrë nga kryetari dhe të miratuar nga Asambleja Komunale. Tash, çdo katër vite duhet të vazhdojë mandati i këtij mekanizmi. Sipas Rregullores, anëtarët janë të përcaktuar me pozita, ashtu qysh i ka paraqit në vendim edhe kryetari. Të gjitha institucionet që merren me parandalim, me mbrojtje dhe me riintegrim të viktimave të dhunës. Po

ashtu, sipas Nenit 4 të kësaj Rregulloreje, ne mund të ftojmë si mysafirë – varësisht prej nevojave, jo anëtarë të rregullt, përfaqësues të ndryshëm, si në këtë rast, ta zëmë, përfaqësuesin e Këshillit të Bashkësisë Islame apo të shoqatës së bizneseve, apo kryesuesin e Asamblesë etj., varësisht prej aktiviteteve që i ndërmarrim në parandalim, apo në mbrojtje. Siç kemi vepruar me Këshillin e Bashkësisë Islame për vite të tëra, kemi pas një bashkëpunim jashtëzakonisht korrekt, duke i shërbyer parandalimit, me thirrjen e mesazheve për mbrojtje nga dhuna dhe kundër këtyre dukurive përgjatë hytbeve për xhuma, e kështu me radhë. Që nga 2013-ta, ky mekanizëm është koordinuar nga zyrtarja për Barazi Gjinore, që tash, sipas Rregullores, do ta udhëheq kryetari i Komunës. Andaj, kërkoj sot nga ju që ky mekanizëm të votohet dhe uroj që, me këtë institucionalizim të këtij mekanizmi, të kemi një mekanizëm edhe më funksional, të kryejë obligimet e vetë konform mandatit ligjor dhe t’u dalim në ndihmë viktimave të dhunës në familje, ashtu si është e paraparë me ligj. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Duke marrë parasysh statistikën në Kosovë, ky mekanizëm lokal koordinues ka një rol shumë të rëndësishëm në Komunën e Dragashit. Më vjen mirë që Dragashi, Opoja dhe Gora në këtë çështje ndoshta janë më poshtë në listë, por kemi pasur raste edhe në Restelicë. Ka raste – ne që kemi informacione dhe që i ndjekim mediat – prandaj më intereson nëse zonja Lindita mund të përgjigjet se sa raste të dhunës në familje ka pasur në Komunën e Dragashit gjatë një apo dy viteve të fundit. Së dyti, propozuesi – kryetari i komunës – duhet të marrë parasysh se në përbërjen prej 18 anëtarësh të këtij mekanizmi lokal, sipas modelit të mekanizmit kombëtar, është paraparë edhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të komuniteteve pakicë, e jo vetëm e shumicës. Ne flasim se nuk kemi të punësuar nga komunitetet joshumicë. Këtë e kam thënë edhe më parë lidhur me buxhetin, por nuk dua tani ta zgjerojmë atë temë. Megjithatë, realiteti është se nuk keni kë të vendosni. Kryetari i komunës – pa zëvendës nga komunitetet pakicë. Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë – dy përfaqësues, përsëri nga shumica. Zyra për Komunitete – vetëm një përfaqësues, sikur atje të mos punonte edhe dikush tjetër. Pastaj nuk ka të tjerë. Kush do t’i mbrojë komunitetet joshumicë dhe kush do të merret me çështjet e barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave? Përfaqësuesi për mbrojtjen e viktimave – shumicë. Përfaqësuesi i gjykatës – shumicë. Prokuroria? Me gjasë nuk ka askënd nga komunitetet joshumicë. Policia? Nuk ka. Në prokurori, sa di unë, nuk punon askush nga komunitetet joshumicë. Unë jam një person i informuar, kryetar. Një nga më të informuarit në këtë komunë. Kam qenë dhe jam pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës. Përfaqësuesi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas është nga komuniteti shumicë. Përfaqësuesi i zyrës së punësimit – i lutem propozuesit që, duke marrë parasysh se drejtori Fitim është në pension dhe se ekziston zëvendësi, për shkak të strukturës të përfshihet Almira. Ky është propozimi im. Shëndeti mendor – përsëri shumicë. Edhe më herët e ngrita dorën, por kryesuesi nuk më pa; nuk mbaj hatër, është Ramazan. Kur patëm këshillimin për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, si është e mundur që në Brod të gjithë ata përfaqësues të shumë të partive politike të shumicës zgjedhin kryetarët e fshatrave? Mund të ishin formuar dy trupa – që opojanët t’i zgjedhin përfaqësuesit e tyre nëpër fshatra, ndërsa ne tri partitë t’i zgjedhim në mjediset tona. Dhe dihet kush ka fituar – ai duhet ta ketë kryetarin e fshatit. Jo që ta vendosim vetëm sa për formë, e pastaj nëse na përshtatet është i mirë, nëse jo –

nuk duam të punojmë me të. Nuk e paguajmë, nuk i përgjigjet askujt. Këto janë gjëra reale dhe kështu ka ndodhur gjatë gjithë këtyre viteve. Le të fillojmë ndryshe. Le të lëmë pas vetes një histori pozitive. Le t'i rregullojmë më në fund disa gjëra themelore, edhe pse duken banale. Ka dhunë edhe në Dragash, raportet janë këtu. Ne kemi traditën më të mirë në Kosovë – ne në Gorë dhe në Opojë nuk i rrahim gratë. Le të merremi seriozisht me këtë çështje, sepse gjërat nuk po shkojnë në drejtimin e duhur.

Lindita Kozmaqi Piraj: Këtë shqetësim e ka paraqit disa herë me radhë edhe përgjatë këryre 13 viteve që po funksionon ky mekanizëm në formën qysh tregova, e ka paraqit këtë problematikë të mospjesëmarrjes, apo iu ka dukur që është pjesëmarrja e ulët e përfaqësuesve gorano-boshnjak, Uzairi, për vite me radhë. Po realisht, në këtë mekanizëm nuk e bëjmë sipas dëshirave dhe nuk kemi të drejtë ne, niveli lokal, të përzihejmë në një Rregullore, që është me pozita. Udhëheqësit e pozitave nëpër institucione janë ata që janë, qoftë shqiptar apo gorano-boshnjak. Por, nuk do të thotë se, në mbledhjen e parë që do ta udhëheq kryetari, do të kërkojë nga të gjithë përfaqësuesit e institucioneve që ta kenë një zëvendës që është anëtar i rregullt, se nuk mundet drejtori gjithmonë me na u përgjigj neve kur kemi raste dhe kur kemi takime, që sipas kësaj Rregulloreje duhet 3-4 në vit, po ne mund të kemi raste kur bëjmë takime edhe Ad hoc. Kështu që, secili drejtor, si i QPS-së, si i QKMF-së, si i Arsimit, kanë me e caktue një zyrtar i cili ka me i përgjigj në trajnime, sepse këtu jemi duke folë për çështjen e dhunës në familje dhe e dini që kjo është një çështje shumë e ndjeshme, dhe kërkon konfidencialitet. Nuk mundemi me i shti anëtarët, sot një tjetër e nesër një tjetër. Duhet të vjen t'i mbajë disa trajnime, t'i dijë disa gjëra, të hyjë në rrjedha edhe të vjen të jetë anëtar i rregullt. Për me ta ilustruar këtë, javën e kaluar kemi pas një trajnim që na u mbajt nga Qendra Strehimore në Gjakovë, dhe drejtori i QKMF-së e ka çu zëvendësen e tij, U.D., ka qenë Behija. Domethënë, pse nuk është këtu me emër, me e mbajtur barrën dhe përgjegjësinë – se ai që është këtu e ka barrën dhe përgjegjësinë ligjore për raste të ndryshme – nuk do të thotë se nuk është pjesë e këtij ekipi punues edhe zëvendësit e tyre të ndryshëm, që janë gorano-boshnjak. Pastaj te rastet, po, ne i përcjellim ato, në takimet e rregullta këto statistika i mbledhim. Për vitin 2025 i kemi pas 17 raste. Ky është numri më i vogël i mundshëm i rasteve të denoncuar në Kosovë. Komunitet tjerë me popullsi sa Komuna e Dragashit, ndoshta edhe trefish e kanë numrin e raportuar. Të mos flasim për komunitet e mëdha, sepse ne nuk krahasohemi me to, por me komunitet si na që janë, trefish më shumë i kanë rastet e raportuara. Nuk do të thotë asnjëherë që rastet e raportuara na paraqesin gjendjen reale, por ne jemi ato institucione që jemi të thirrura me punue, me i parandalu, me i mbrojt, me vepru atëherë kur ka nevojë.

Bexhet Xheladini: Edhe pse përfaqësuesja i dha sqarimet, këtu nuk bëhet fjalë për kurrfarë diskriminimi. E dish që këtu, prej se kam ardhë unë si kryetar, përqindjen e të punësuarve nga 23% e kam rritur në 28%. Pastaj, ti e dish që numrin e drejtorateve e kemi 8 dhe 4 prej tyre janë nga komuniteti joshumicë. Nuk duhet këtu me dalë dikush edhe me u paraqit se është shpëtues i komunitetit boshnjako-goran, pa argumente dhe pa fakte. Ky Propozimvendim për themelimin e Mekanizmit Koordinues Lokal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, ku jam unë kryetar dhe e udhëheq këtë, propozimet janë bërë në bazë të Rregullores që e ka hartue Qeveria e Kosovës. Edhe bartës të këtyre emrave janë përfaqësuesit e

institucioneve. Tash, nga Komuna ne i kemi dy, por institucionet tjera që janë jashtë Komunës – Policia, gjyqësia, hetuesia – ata ka mundësi që përfaqësuesin e vet e bien nga komuniteti. Po ne nuk mundemi me iu përzie atyre. Do të ishte mirë, unë edhe dje kam propozuar, që te kjo OJQ, që është një përfaqësues i OJQ-së, të kemi parasysh që këtu ta propozojmë një emër nga OJQ-ja nga komuniteti joshumicë që operon në regjionin e Gorës, edhe pse në regjionin e Gorës nuk kemi OJQ e cila merret me problemin e dhunës në familje. Por megjithatë, ne mund ta bëjmë këtu një lëshim, në mbledhjen e parë kur ta mbajmë, do ta diskutojmë këtë çështje. Edhe mbeta borxh, do të kaloj në pikën ku u bë pyetje për stadionin e Blaçit. Unë e mora kontratën, paramasën dhe parallogarinë, edhe këtu titulli i projektit është kështu: "Paramasa dhe parallogaria e punimeve të stadionit në fshatin Blaç dhe rregullimi i infrastrukturës në fshatin Blaç". Në kuadër të kësaj janë të parapara 283 mijë euro, projekt trevjeçar, ku 188,485 janë paraparë për stadionin, 25 mijë për punimin e kanalizimit të ujërave të zeza, edhe 70 mijë janë të parapara për kubëzimin e rrugëve me kubëza betoni të trashësisë 80 mm, është e paraparë edhe sipërfaqja. Vitin e kaluar janë kryer punimet vetëm të kubëzimit, këtë vit kryhen punimet e stadionit.

Resul Fetahu: Faleminderit! E hedhim në votim! Kush është për? A ka kundër? Abstenim a ka? Konstatojmë se me 19 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e pestë: Propozimvendim për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës. Kush do me e marrë fjalën lidhur me këtë pikë?

Granit Rifaj: Para se me fillue te pika e pestë, dashta me folë – se kryetari tha po folim me dokumente – veç me i kallxue kryetarit që këto dokumente nuk i kam prodhue unë, na i keni dërgue ju: Ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaç, 70 mijë euro. Jo i kubëzave me diametër, me milimetër, me rrugë, por ndërtimi i stadiumit. Këto janë dokumentet, a në qoftë se i kanë bo këta gabim, atëherë le të na sqarojnë. Ama qetu është stadiumi, ndërtimi i stadiumit, janë pague 70 mijë euro. Kryetar, po më vjen keq, se nuk e kam personale me ty. E ke 52354: Ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaç, 70 mijë euro buxhet, 70 mijë euro të shpenzume. Qeky dokument nëse rren, po të rrej unë, kryetar. Okej, atëherë në ndërtim të stadionit nuk janë punue, thaje vetë.

Resul Fetahu: A do me e marrë dikush fjalën për pikën e pestë?

Qamil Kolloni: Sa i përket Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë, dua të kërkoj që ta miratoni këtë. Dje kemi pas një pyetje nga një delegat, të arsyeshme po mendoj, rreth disa pronave të cilave iu mungon metri katror. Neve na duhet me e sqarue se Lista e Përgjithshme përfshin pronat komunale të cilat janë si tokë dhe si parcela. Në këtë rast, me parcelën numër 9051 kemi diku 8986 metër katrorë, përfshin rrugët, banesat dhe sheshi para Komunës. 782 – kemi 50 ari e 24 metër katrorë, që përfshin Gjykatën, objektin e Arsimit dhe Postën. Edhe Postën ne e kemi shti, sepse toka realisht është pronë komunale, pavarësisht pse ajo është rregulluar pastaj me kontratë dhe e menaxhon PTK. Prandaj, të gjitha këto kemi planifikue që t'i qesim si tërësi në metër katrorë, dhe unë kërkoj që, pas revidimit të këtyre të cilat i kemi nxjerrë nga Gjeoportali, ta plotësojmë këtë Listë të Përgjithshme, dhe Listën e Veçantë kështu siç është, dhe nesër t'i çojmë për miratim ligjor në MAPL.

Usmen Baldzi: E ja që pata të drejtë. Kjo pikë e rendit të ditës më jep përgjigje se duhet të punojmë, dhe ndonjëherë edhe të dëgjojmë ata që dinë diçka. Në seancën e kaluar, në dhjetor,

kjo listë nuk kishte shumë vërejtje. Ju nuk i pranuat, ajo shkoi në Prishtinë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal na e ktheu dhe morëm një autogol – kështu e kuptoj unë, dhe më vjen keq. Tani zoti drejtor e ka korrigjuar dhe do t'i marrë votat. E pse? Sepse nuk dëgjojmë.

Artan Loshaj: Përshëndetje, të nderuar! Sot ne po diskutojmë për Listën e Përgjithshme dhe të Veçantë të pronave. Para dy muajve kjo ka qenë në Kuvend. Që 4-5 vite pushtet, të njëjtat lista, copy-paste i keni pru. MAPL-ja i ka kthye prapë për përmirësime. Janë bo disa përmirësime, dje e kam pyet drejtorin, nuk është veç një parcelë, por janë 12 parcela. Ato janë me numër 36, 37... deri te 153-shi. Ky e hudh fajin te drejtori i Urbanizmit, se kështu ia ka pru materialin. Atëherë, i nderuar kryetar, dhe ti drejtor, pasi kanë qenë të mangëta këto, si është e mundur t'i pranoni nga drejtori edhe t'i qitni këtu për votim. Dje në Komitet – se unë nuk kam shumë qef këtu në seancë, diskutoj në Komitet ku kam ma shumë kohë edhe mundësi, aty i shterri debatet me ju – dje je arsyetue se këto parcela janë janë kullota dhe rudina. Jo, z.drejtor, këto ju shkruajnë juve që janë, për shembull, Komuna e Dragashit është tokë për biznes, 142, pra tokë për biznes. 143 – lokal afarist, e mos të shkojmë më tej. Këto nuk janë rudina, edhe këto nuk janë kullota, po këto janë lokale. Edhe, për këto 12 parcela me siguri ndonjë qytetar është i interesuar me e marrë me qira edhe me e shfrytëzue. Si është e mundur, pa metër katror ju me e qit këtu. Të kam kërkue edhe herën e parë, po të kërkoj edhe tash, përmirësoje këtë. Ose qite mirë, ose largoi këto 12 parcela. Kur ishte muhabeti që e hudhët fajin te drejtori i Urbanizmit, sot po më vjen mirë që i kemi të dy drejtorët e CDU-së, këta po më vjen çudi që e paskan ngue kryetarin, se këta nuk vijnë këtu, këta nuk janë të interesuar për qytetarin, nuk janë të interesuar për me i përmirësue këto gabimet, këta janë të interesuar me pas ndonjë tender, ndonjë projekt, ndonjë përfitim të vetin. E, pikërisht sot, po due me i thënë kryetarit – se pat premtue që kerrat zyrtarë nuk i lënë me i keqpërdor – zyrtari për Kthim e merr veturën, nuk është problem, është arsyetue se i bart nxënësit, në rregull jemi. Po sot, rastësisht kam shkue me bo kopje, se punëtori i cili punon në Shërbim është hidhërue me mu edhe nuk po më bën kopje si delegat – po unë shkoj me pare, me euro i bëj këto, që në çfarë gjendje e keni pru Kuvendin – duke bërë kopje, vjen drejtori i Drejtoratit të Shëndetësisë me kerr zyrtar në ora 09:30, mas syfyrin e kish zënë gjumi, në ora 09:30 vjen me kerr zyrtar. Kryetar, a po i ndalish pak, ndale dorën, kryetar. Drejtori të vjen me kerr zyrtar në punë sot, në ora 09:30, drejtori Behar Brenoli. Ke premtue që keqpërodrimet do t'i ndalish. Edhe një euro me e keqpërdor është shumë, kryetar, se është para publike, nuk është para e xhepit tuaj. Thashë edhe një herë, ndale se, me zor, bile ke t'u m'shkelë, nëpër gjumë ish konë, ish ngut pak, për me ardhë me u përgatit për seancë. Ndërsa, te Lista e Veçantë, nuk jam kundër kësaj, por po më vjen çudi, si është e mundur, z.drejtor edhe kryetar, që para dy muaj, në Listën e Veçantë i keni pru për t'i votuar 98 parcela. Për dy muaj ditë, çka ndodhi, z.drejtor, veç pesë parcela. Ku hupën 93 kërkesa për dy muaj ditë? A nuk t'ka punue printeri, a t'ka zënë Ramazani, diqysh po m'doket që po qeshesh me ironi, si një tut, një stres e ke pak. Çka është duke ndodhë, pse po hyjsh laknave edhe po përzihesh në kompetencat e drejtorit të Urbanizmit që e ka ulë kryet. Këto dokumente janë të Urbanizmit, drejtor. Qysh është e mundshme – unë do të votoj, veç më trego si është e mundur për dy muaj, nga 98 parclea të cilat kanë qenë të interesuar qytetarët, sot i ke në dokument veç 5. Po më vjen shumë keq, shqyrr edhe qeta 5, se e kanë parë njerëzit që nuk jeni seriozë edhe po largohene dhe prej këtyre sendeve. Pse,

drejtor? Pse nga 98 parcela, veç 5 sot janë në kërkesë për në Listën e Veçantë, për me i votue na edhe me i dhënë me qira? Faleminderit!

Qamil Kolloni: Po më vjen mirë që kemi nis me të mësue me u bo i mençur, se ti me pas ditë, këto ke mund me i kërkuje para 2021-tës, që kurrë nuk i kanë paraqit edhe ke qenë pjesë e këtij Kuvendi. Të nderuar delegatë, me numër të parcelës 782, 19 është Posta, me numër 781 janë ndërtesat kolektive. Me numër 782, numër 17 është ndërtesa e arsimit. 782 – 0 është parkingu tash ku është duke u ndërtua Qendra Multifunktionale. 782 – 20 është gjykata, 781 prapë është ndërtesa, 11 është një lokacion te Lumi i Rapçës, dhe 014 gjithashtu është një lokacion pranë Lumit të Rapçës. 770 është rruga prapa Shtëpisë së Kulturës, është pronë komunale. 771 është Shtëpia e Kulturës, është pronë komunale. 772 - 2 është Amfiteatri i kulturës. 773 -1, ndërtesa e Sharrprodhimit, toka, parcela, është pronë komunale. Dhe 774 rruga e Gjymnazit, është pronë komunale. Parcela numër 905 – 1, 89 ari, është pronë komunale e cila fillon prej Komunës, deri te Shtatorja e Adem Jasharit. Prandaj, të gjitha janë këto prona. Ju e dini se e kemi Rregulloren për Dhënie në Shfrytëzim të Pronë Komunale nën një vit, dhe me atë rregullore rregullohen të gjitha ato prona të cilat jepen nën një vit. Në mesin e atyre pronave ne kemi mendue që t'i fusim në Listën e Përgjithshme për t'ua vazhduar kontratat. Meqenëse ato janë nën një vit, nuk i takojnë kategorisë për dhënie në shfrytëzim në bazë të këtyre regjistrave. Pra, i japim, i vazhdojmë kontratat, dhe në momentin kur ka nevojë, Komuna i shkëput kontratën me ato biznese. Për këtë arsye, interesi i Komunës për këtë vit është që të shkojë me këto 5 parcela për dhënie në shfrytëzim. Nuk ka interes tjetër, në qoftë se do të ketë vitin tjetër, mund ta plotësojmë listën edhe të japim prona me qira. Për këtë arsye, unë mendoj që me ato plotësimet të cilat i thashë, edhe nuk kanë qenë aty, prej Gjeoportalit do t'i marrim, për arsye se nuk kanë pas prerje gjeodezike nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrës, t'i qesim në bazë të Gjeoportalit, meqenëse tash na mundëson Gjeoportali ta bëjmë një gjë të tillë, t'i plotësojmë edhe ato dhe ta dijmë se Lista e Përgjithshme i përfshin të gjitha pronat të cilat i kemi në menaxhim. Kjo nuk është më perfektja, mund të ketë edhe ndryshime, disa prona që i kemi në kontest mund t'i shtohen ose mund t'i hiqen. Prandaj, gjendja faktike është kjo, dhe unë mendoj që, me propozimin të cilin e dhashë, do të ishte që delegatët ta votojnë, dhe ne besojmë se do ta bëjmë më të mirën të mundshme, sepse për secilën parcelë veç e veç përcaktohen kushtet në bazë të kontratës. Dhe komisioni formohet pikërisht prej këtij Kuvendi. Nuk ka mënyrë më transparente se kur kalojnë të gjitha vendimet përmes këtij Kuvendi. Dhe tash, pse doni veç ta shprehni mllëfin këtu, unë nuk mundem me ju shërue juve.

Artan Loshaj: Kryesues, qysh në ditën e parë kur ta kam urue pozitën, kam kërkuje mos ta lini Kuvendin si në mandatin e parë me ish-kryesuesen. Mos i lejo drejtorët me na ofendue. Kryesues, unë e di që je nga LDK, ti je kryesues i të gjithë delegatëve. Unë nuk dola prej temës, po unë e diskutova, se dje shumë mirë ke qenë prezent kur ka thënë janë kullota dhe rudina, edhe kur ka thënë drejtori i Urbanizmit ma ka prurë kështu listën. I kam lyp publikisht kryetarit që drejtorët e CDU-së të jenë prezent, se po na neglizhojnë neve, po i neglizhojnë qytetarët, kam qef që pyetjet direkte me ua bo atyre në foltore, mos me folë unë nëpër komitete. Kryetari na ka premtue, kanë ardhë. Në qoftë se unë gënjej, kur i ke pa – që drejtori iku, nuk është drejtori i Shëndetësisë këtu, ai drejtori tjetër luan në telefon letra ose domino, edhe unë nuk kam ofendue kurgjo, unë kam thënë

që kjo listë është e drejtorit të Urbanizmit, edhe konkretisht drejtori i Urbanizmit duhet neve me na dhënë sqarime këtu, e jo drejtori i Financave. Në rregull, e vazhdojmë me këtë. I nderuar drejtor, si është e mundur për dy muaj ditë, nga 98 në 5 kërkesa? Ti, ju, në fund të dhjetorit e keni prurur këtë listën me 98. A ke pa ëndërr e je trishtue, e i hoqe këto, a çka është puna? Qetu nuk po japish përgjigje ti. Unë konkretisht te qekjo, pse nga 98 në 5, pse është kaq rënie drastike menjëherë? Mu po më vjen keq pse njerëzit nuk po dojnë në Listën e Veçantë me marrë pronat, na kemi pronat me iu dhënë krejtve, edhe do t'u japim. Pse e ndryshove Listën? Qet përgjigje unë e due direkte, mos shko për okolla me na qit hi syve ti. Pse prej muajit dhjetor, nga 98 në 5? Edhe mos ta kishte prurur Ministria prapë, ti qeto do ta votojshe me 98, edhe do të formojshe komision me qet listën.

Qamil Kolloni: Shumë e thjeshtë është. Objektet nuk janë të Komunës, flasim për pronat. Parcela është 21 metër katrorë dhe i takon dhënies nën një vit, dhe me kontratë këto jepen në bazë të Rregullores së Kuvendit për Dhënie në Shfrytëzim Nën Një Vit të Pronës Komunale. Shikone dhe lexone ligjin! Për atë arsye, këto parcela janë hek prej listës për dhënie në shfrytëzim dhe do të jepen me Rregulloren për dhënie në shfrytëzim nën një vit, që do t'u vazhdohet këtyre veprimtarive që të kryejnë veprimet e tyre ekonomike. Dhe për 15, 20, 21 metër katrorë, Komuna nuk është e interesuar që t'i vë para aktit të kryer bizneset, po ua lehtëson veprimtarinë që ta kryejnë brenda territorit të Komunës, përderisa këto parcela nuk janë në interes të përgjithshëm ose në interes publik të Komunës së Dragashit. Për këtë arsye do të vazhdojmë me të njëjtin ritëm që këto biznese së paku të kenë ngat vetes një kontratë për kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 13 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë: Miratimi i Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2026-2028. Kush dëshiron me e marrë fjalën lidhur me këtë pikë?

Artan Loshaj: Kryesues, herët ia ke nis me inat politike këtu. Qe dy-tri seanca ke fillue me qenë kryesues. Delegati ka të drejtë me i shterrë... se është vendi i delegatëve këtu, e jo i drejtorëve. Nuk jam i kënaqur me pyetjen, po më shtish tash me shkue në eventuale edhe me dalë prej temës. Nuk kam qenë i kënaqur me pyetjen me zotërinë edhe prapë po due me m'kthye përgjigje. Qe pesë vite ju jeni në pushtet, të njëjtën listë me 98 parcela e keni prurur. Ku u vetëdijesove, ku u bone i mençur për një natë ti? Mos me pas qenë Ministria, ti prapë me 98 parcela ke pas me e votue edhe me qeto me funksionue. Po rreht pikës, po nuk ma dhaje fjalën ti mu. Unë po due me të respektue, mos u sill kështu! Delegati ka të drejtë edhe dhjetë herë me dalë, Baldzi doli pesë herë, Graniti njëzet herë, mu s'po ma japish fjalën. Mbroje drejtorin ti në fushatë, mos e mbroj në foltore këtu! Njëse, kërkoj falje! Dalim në pikën e gjashtë. Të nderuar kolegë, tash po diskutojmë për Planin Komunal për Integrim të Qëndrueshëm, është një çështje me rëndësi të veçantë. Po më vjen shumë mirë që z.Uzairi i ka vu dëgjueset edhe ka me m'ngue shumë mirë. Po është mirë edhe kryetari me m'dëgjue. Due me e bo një pyetje shumë konkrete, se s'po due shumë, se i kemi shterrë dje debatet në zyrë të kryetarit, pasi kemi dalë prej këtu. Po sot pak një troh, si ma omël edhe ma butë do ta diskutojmë edhe do të bëjmë zgjidhje. Due me e bo një pyetje konkrete: Qe sa vite je zyrtar për Kthim, a ka mundësi me ma kallxue një rast të vetëm të riintegruar në komunitetin e Dragashit, real, që u kthye prej jashtë edhe që jeton këtu. Ma tregoni një të punësuar, që e keni punësuar ju

bashkë me kryetarët – se je një kohë të gjatë – ma trego një fëmijë, i riintegruar, që shkon në shkollat boshnjake, gorane, shqiptare, nuk është me rëndësi. Po këto, në qoftë se m’i shpjegon ti mu këtu, prapë unë do t’i bëj do pyetje, se kemi shumë për me pyet këtu. Mu më vjen keq që edhe kryetarët e mëhershëm të PDK-së, po edhe ky kryetari, ju kanë lejue juve që këta persona në Gorë t’i shfrytëzoni për vota, për elektorat. Kur vjen koha e zgjedhjeve, Zyra për Komunitete dhe Kthim – qe, e paska një zyrtar këtu – është rend t’u prit për me u regjistruar aty, se do të japin subvencione edhe keni dhënë subvencione. Kanë ardhë në pushim, kanë marrë subvencione, kur kanë marrë me shkue i kanë shit ato subvencionet. Ato shpia që jua keni marue, ju keni marue njerëzve që i kanë bo keq vendit, njerëz që janë hala të uniformuar, edhe njerëz që vetëm vijnë për piknik edhe vijnë në pushime kur kanë ndonjë dasëm ose ndonjë vdekje, vijnë në ato shpiat që i keni marue ju. Asnjë person të cilit i keni bo riintegrim nuk qëndron në Kosovë. Më vjen keq, se ju këta i shfrytëzoni për vota, kur vjen koha e votave, ju bashkë me drejtorat e CDU-së, kam dokumentacion edhe keni qenë vetë prezent në Mal të Zi, në Maqedoninë e Veriut, në Serbi, dhe ju keni ofrue dokumentacion, ju keni ofrue që, hajdni votoni – trenin bullgar – hajdni votoni se ne do t’ju marojmë. Mas zgjedhjeve – po më vjen keq, se shumica janë të zhgënjyer nga ju – edhe kërkoj hetim këtu. Në qoftë se drejtori, zyrtari, na jep sqarim – ndoshta e kam gabim unë – që ka të riatdhesuar që jetojnë në Kosovë, e jo që jetojnë në gurbet edhe që jetojnë nëpër vende të regjionit, unë do të tërhiqem. Por, në qoftë se nuk ka, unë atëherë me siguri, duhet edhe kryetarit që ka lejue, edhe drejtorit, me iu ngrit ndonjë padi edhe me e thirrë prokurorinë edhe gjykatën, me pa çka është duke ndodhë, se këto nuk janë pak pare, po këto janë bajagi.

Usmen Baldzi: Është e rëndësishme që këtë çështje ta njohin jo vetëm komunitetet joshumicë, por edhe komuniteti shumicë. Të përgëzoj, Artan, për prezantimin tuaj. Unë vetëm dua të shtroj një pyetje lidhur me dy raste. Ky është një dokument për riintegrim të qëndrueshëm dhe ne, sipas ligjit dhe rregullave, duhet ta miratojmë. Plani që është përgatitur nga zyra, më saktë nga zyrtari që merret me riintegrimin dhe që harton këto rregullore, është bërë sipas disa rregullave ligjore të cilat i zbatojnë të gjitha komunat që merren me kthimin në Kosovë. Por ajo që ngriti Artani është absolutisht e saktë. Dhe gjatë gjithë kohës përpiqem të theksoj – mos, mos – sepse në fund një pjesë e buxhetit mund të përfundojë në ndonjë “prokurori”. I pyes organet përgjegjëse: çfarë ka ndodhur me kthimin e familjes Maslar nga Brodi? Ishte në listë, nuk e di emrin e gruas. Asgjë nuk është bërë, ndërsa ishte në listë që t’i ndërtohej shtëpia. Çfarë po ndodh me atë rast? Gjithashtu pyes: nëse ky është kthim i qëndrueshëm, a mund të quhet i qëndrueshëm ndërtimi i shtëpive vikendi dhe sezonale që po bëhen nga organet kompetente në komunë? Më vjen keq, ka shumë gjëra për të cilat flitet, por është më mirë që këto t’i hetojnë institucionet kompetente dhe jo ne vetë, në mënyrë që të mos bëhemi bashkëpjesëmarrës në këtë histori.

Uzair Hamza: I nderuar, përshëndetje për të gjithë delegatët. Me shumë kënaqësi do të përgjigjem në të gjitha pyetjet, megjithatë, në fillim të prezantimit tim duhet të theksoj se këtu ka një keqkuptim. Pyetjet që janë parashtruar lidhen me një temë krejt tjetër. Riintegrimi i personave të zhvendosur merret nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa zyra për komunitete, në përputhje me ligjin, kryen detyrat e Ministrisë. Ju e dini që një nga kushtet për liberalizimin e vizave ishte nënshkrimi i dokumentit për readmision, domethënë pranimi i qytetarëve tanë që ndodhen në vendet e Evropës Perëndimore. Pra, pranimi – dhe ky është pjesa e parë e strategjisë që ka zbatuar qeveria e Kosovës bazuar në Urdhrin 22 të vitit 2020. Në bazë të kësaj, komunat kanë përgatitur strategjitë e tyre, duke vlerësuar autoritetin e qeverisë sipas këtij urdhri. Pjesa e dytë e strategjisë që po miratojmë tani lidhet me pranimin, mirëseardhjen dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Pra, si shef i zyrës dhe person që merret me këtë çështje prej kohësh, isha i detyruar të sqaroja këtë tematikë. Këtu shtëpitë e familjeve që kthehen nuk kanë lidhje me personat që janë kthyer nga vendet e Evropës Perëndimore. Termi “person i repatruar” nënkupton një person që ndodhet në një vend të Evropës Perëndimore pa dokumente valide. Kushti i parë i qeverisë së Kosovës për liberalizimin e vizave ishte nënshkrimi i dokumenteve me vendet e Evropës Perëndimore për të pranuar qytetarët tanë dhe për t’u mundësuar integrimi i tyre në shoqërinë kosovare. Kjo është pjesa e parë që është realizuar, dhe në bazë të saj kemi marrë liberalizimin e vizave. Dokumenti që kemi sot lidhet me integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Pra, madje as Kuvendi nuk do të duhej të diskutonte për këtë çështje – ky është një dokument qeveritar, strategji e qeverisë, jo dokument i zyrës apo i komunës. Por ai shpjegon hapat se si integrohen personat që janë kthyer nga vendet e Evropës Perëndimore. Vetëm për t’ju rikujtuar – në nivel rajonal ekziston një koordinator rajonal që bashkëpunon me zyrën, dhe kur një person kthehet, ai regjistrohet, kryhet vizitë në terren dhe dokumentacioni i përcillet ministrisë sipas nevojave. Kjo është një pjesë. Nuk shmangem të përgjigjem as në pyetje të tjera, edhe pse nuk lidhen me këtë temë. Këtu pyetjet janë parashtruar edhe në bazë të kthimit të personave të zhvendosur sipas Urdhrit të ri 1/2018, dhe aty pyetjet ishin sa persona jetojnë në shtëpitë që u janë ndërtuar. Ju e dini që nga viti 2013 deri në 2024, komuna e Dragashit kishte një listë të miratuar me 18 familje që do të ktheheshin, por realizimi nuk ishte bërë. Fatkeqësisht, në atë kohë në ministri ishin ministra që shpesh financonin projekte në komunitetet serbe. Me ardhjen në pozicionin e ministrit, Rashid miraton ndërtimin e gjashtë shtëpive nga lista e miratuar në 2013. Paraardhësi, Mehmet Hamza, ishte atëherë shef i zyrës, ndërsa Vezaip merrej me problematikën që po diskutojmë sot. Pra, Rashid merr vendim për të ndërtuar gjashtë shtëpi për familjet që kthehen nga ajo listë, e cila ishte miratuar që në 2013 dhe çdo vit konfirmohej. Delegat Artan Loshaj, a jeton dikush në ato shtëpi? Fatmirësisht, vitin e kaluar, 2024, janë ndërtuar tre shtëpi nga gjashtë. Nagip Ibrahim i jeton në Dragash, Kami Redžić po ashtu në Dragash, fëmijët e tyre shkojnë në shkollë, ndërsa Emina Vejapi jeton në Zlipotok. Në vitin 2025 është ndërtuar edhe një shtëpi për Fitmija Bislimi, por ende nuk është banuar në Krstec sepse nuk ka lidhje me rrymë dhe ujë. Sa i përket pyetjes konkrete, në atë listë ishte edhe Jasmina Maslar. Meqë delegati nuk e dinte as emrin e saj, dhe dëshironte të ishte human, unë do ta sqaroj – ajo është nga fshati juaj. Arsyeja pse shtëpia e saj nuk është ndërtuar është sepse nuk ka parcelë

adekuate. Personi është invalid, dhe vendi ku ka parcelën nuk është i përshtatshëm. Për ministrinë, ata që kanë kërkuar gjetjen e një zgjidhjeje thonë se rasti i saj është ende në proces. Pra, nëse gjendet zgjidhje, për shembull nëse dikush nga banorët e Brodit ofron parcelë, komuna sërish nuk ka mundësinë ta ofrojë direkt. Unë kam propozuar që, sipas ligjit për dhënien e pronës së paluajtshme, komuna të shpallë interes publik – kthimi – dhe në këtë mënyrë të mundësohet dhënia e parcelave për njerëzit që kthehen dhe nuk kanë tokë të vetën. Pra, kjo është përgjigjja përafërsisht. Kam prekur edhe disa çështje për të cilat ndoshta nuk ishte e nevojshme të përgjigjesha në këtë moment. Faleminderit.

Usmen Baldzi: Rregullat e kthimit, procedurat e kthimit, readmisioni – i dimë shumë mirë, zotëri shef i zyrës. Dhe nuk ka nevojë t'i përsërisim, sepse që në fillim kam thënë se do ta miratojmë këtë. Por duket qartë se këtu nuk po dëgjohet, ndoshta nga inati. Kemi shumë për të thënë, por tani nuk është momenti. Të nderuar miq, me respekt të madh për partitë politike shumicë, sot në pushtet është LDK, dhe niveli juaj intelektual, duket këtu, me disa sulme të ulëta në Kuvendin e komunës së Dragashit, të cilën unë realisht dua ta bëj më të mirën në Kosovë. Gjërat shkojnë aq keq sa... Çfarë performancash do të kemi këtë vit? Kryetar, të ndihmojmë, kryetar. Ajo që foli zotëri – do ta miratojmë. Nuk e bëri ai, e bëri zyra. Në atë zyrë punon dikush – Fitim Spahiu – dhe e bëri ai. Dhe do ta miratojmë, sepse është dokument qeveritar sipas ligjit. Nëse nuk kishte nevojë që kjo të diskutohej në Kuvend, pse e keni propozuar? Tani thotë – shef, nuk ka nevojë në Kuvend për qeverinë... Pse e keni propozuar? Kryetar, qëllimet tona janë të mira, mos lejoni, ju dhe ju kryetar i Kuvendit, sulme të ulëta. Nuk e di emrin e saj. Emrat e grave nuk përmenden tek myslimanët, veçanërisht në jetën publike. Zotëri shef i zyrës, unë thashë Maslar. Tani do t'ju pyes – cilat janë kriteret për dhënien e atyre shtëpive? Kush ishte kriteri në Krstec? Çfarë nuk është përfshirë ende në listë? A është gruaja e një ish-policie? Po. Nuk është asgjë e keqe. Pse nuk e thatë? Pse heshtni? A janë Kamir Redžić dhe ky kthyes? Jo. Jetuan në Dragash, kanë vetëm dokumentin e regjistruar. Dhe e dimë të gjithë. Por mos e mbrojni kështu. Ju mbroheni pak – doni të poshtëroni dikë? Jo, zotëri, kështu nuk bëhet. Ju jeni shumë gjatë në atë zyrë dhe mos përdorni dokumente ligjore, tregoni urdhrat sikur dini diçka, e ne nuk dimë çfarë është readmisioni. Kujdes, për Zotin. Dhe nuk dimë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe çfarë është riintegrimi. Bukur pyeti njeriu: A kemi punësuar ndonjë kthyes? Jo. Pra, i thoni – nuk kemi, dhe nuk është faji juaj. Nuk kemi dhe nuk është turp. A do të punësojmë? Do të përpiqemi. Kështu përgjigjet njeriu në Kuvend. Kështu përgjigjet ai që mban pushtetin ekzekutiv. Kështu përgjigjet shefi i zyrës prej shumë vitesh. Kështu përgjigjet drejtori. Nuk duhet të grindemi. Bukur, qetë, ngadalë, pa grindje, pa sulme të ulëta. Dhe e thashë, mos. Gjatë gjithë ditës lutem, vetëm të qetësohemi. Këta “kck”, ky kështu, ky ashtu... Super. Të dy, por më shumë më pengon ky nga VV, unë do ta filloj në shqip... do të flas shqip sepse përkthyesi nga shqipja në boshnjakisht-serbisht nuk e bën mirë, këtu duhet të thuhet serbisht dhe jo të rrisht anash, nuk është në nivel. Kam dëgjuar televizionin Opoja, në seancën e kaluar, më përkthen shumë gabim, e kuptoj që kur flas, ndonjëherë më kuptoni, ndonjëherë jo. Nëse flas shqip, opozita ime nga Gora që është në pushtet tani thotë... ai është shqiptar dhe kështu e kështu. E di që pushteti ka 11 vota, e di që humbëm zgjedhjet, kështu si jemi. Kryetare, a mendoni se duhet të vijë prokuroria këtu? A jeni

për? Me këto fjalë do të vijë. Në Rapcë, 70,000 euro, ka disa probleme, dhe unë mendoja, hajde të... Sot kemi miratuar raportin, kush e ka propozuar përgjigjet për të. Ju lutem, kryetar, për herë të fundit ju lutem – për qëllim të mirë, për një qëllim të mirë, për klimë të mirë. Ju lutem kryetarin, dhe apeloj që bartësit e pushtetit ekzekutiv – drejtorë, shefa, etj. – në Kuvend, kryetar, nuk mund të flasin në këtë mënyrë...

Artan Loshaj: Edhe Baldzi e diskutoi, po konkretisht, sa familje janë, sa janë të punësuar edhe sa fëmijë shkojnë në shkollë? Ai doli këtu publikisht na tha që janë një 2-3 familje, me emra i pëmendi. Nuk po due bre me diskutue, ata jetojnë këtu, se unë jetoj bashkë në Dragash me ta, ky jeton në Kërstec. Unë jetoj në Dragash me këto familje. Ndoshta prej mahallës nalt e deri në mahallë të poshtë, ose prej shpisë së vjetër në shpi të re ka dalë. Këto i ka bo për vota, le ta pranojë një herë. Po, kur vjen koha e votave, treni bullgar fillon prej Restelicës e në Leposaviq, prej Restelicës e në Shkup edhe deri në Beograd. Vetë ky personi shkon, Uzair Hamza, Behar Brenoli, shkojnë vetë në Maqedoni, nëpër telefona i kam screenshotat e tyre. Le ta pranojnë, po, e bëjmë për fushatë. E keqpërdorin këtë riintegrimin për fushatë zgjedhore. Këtyre nuk iu intereson këtu katër vite, një muaj, dy muaj, tre muaj para zgjedhjeve, vetë personat kur vijnë në komunë – i takoj, se jetoj në Dragash, edhe jetoj me goranët unë këtu. “Ej, z.Uzairin mos e paje bre, po më duhet me u regjistruar te Zyra e Punësimit”. Ky bre vetë i çon me koordinata. Ky për fushatë e bën, po, se unë nuk due me e godit. Le të më thotë një herë sinqerisht këtu, jo me u bo pelivan si drejtori i Financave. Unë e di që është pelivan, se 20 vjet është në pushtet. Një herë le të bëhet i sinqert, po me thënë, vallahe e kam shfrytëzue, kërkoj falje, herën tjetër nuk do ta bëj, ose do ta minimizoj. Vetë trenin bullgar e lëshon, vetë shkon në Beograd. Behar Brenolin e çon në Mal të Zi, se i ka familjarët, në Maqedoni e çon këtë të Brodit, vetë shkon në Beograd, edhe i bjer me autobus, në 07:30, i bjer me i regjistruar, në ora 19:30 në akshom i kthen prapë, kur vjen puna e votave të dielën, e lëshon autobusin prej Beogradit, i votojnë, i mbledhin votat. Le ta pranojë realitetin, nuk është ky riintegrim. Këta personat që i përmendi, edhe një herë, janë tri familje të respektume, shumë të nderume, bashkëjetoj me këta, nuk janë të riatdhesuar. Iu bën dokumenta fals në Rozhajë.

Uran Halimi: Unë nuk po due me marrë shumë kohë për këtë pikë të rendit të ditës, kisha bo një propozim ose kërkesë, që minutat e fjalimit tim jepnja z.Baldzi, se po e folën të vërtetën. Ta dëgjojmë pak! Të lutem!

Granit Rifaj: Shumë shkurt unë këtu, se pak a shumë i tha edhe shefi i Zyrës. Kenë këtu sa punësime janë bo, me na i dhënë me shifra, ose mbështetje me projekte Start Up, qysh i bëjnë këta, sa shtëpia. Po në qoftë se janë ndërtue qekaq shpi, për shembull, janë riatdhesue katër familje, ato katër familje a shkollohen në sisteme paralele të Serbisë apo në sistem të Republikës së Kosovës. Edhe përzgjedhja qysh bëhet e këtyre. Edhe, në emër të Grupit të PDK-së dashta me e dënua atë aktin se qysh ia ndalet fjalën Baldzit. Për ne është e papranueshme! Praktika e daljes prej rendit të ditës në seancë të sotme ia ka nis prej kryetarit. Faleminderit!

Uzair Hamza: Duhet të kthehemi te tema. Pra, sa i përket personave të repatruar – ne nuk i kemi ndërtuar shtëpi askujt. Para dhjetë vjetësh, për një person të repatruar nga vendet e Evropës Perëndimore, gjithashtu nuk është bërë asgjë. Por kemi ndërtuar për familjet që kthehen.

Megjithatë, sot po flasim për repatrijimin dhe dokumentin për repatrijim. Pra, kur flasim për repatrijim, nuk i kemi ndërtuar shtëpi asnjë personi. Këtë vit kemi regjistruar 5 familje. Fitim merret me këtë problematikë dhe mund ta shpjegojë më hollësisht. Ne kryejmë regjistrimin, dhe aty nuk regjistrohen vetëm anëtarët e komuniteteve pakicë. Të gjitha personat – shumica dhe pakica – kur kthehen nga vendet e Evropës Perëndimore, regjistrohen në zyrë. Por, fatkeqësisht, Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka fonde dhe nuk ka dhënë mjete, përveç ushqimit dhe disa mjeteve të nevojshme. Kemi pasur rastin kur i kemi paguar një familjeje qiranë për 6 muaj, por kjo ka qenë disa vite më parë. Sa i përket pyetjeve që nuk lidhen direkt me temën, por për të cilat jam përgjigjur më parë – Kamir Redžić ka katër fëmijë, fëmijët e tij shkojnë në shkollë. A është sipas sistemit kosovar apo serb, nuk e di me hollësi. Principi i regjistrimit është ky: sipas urdhrit për personat që kthehen, një person i zhvendosur është ai që ka lënë Kosovën nga marsi 1998 deri më 31 mars 2004. Kjo është e përcaktuar në urdhër. Personat kanë letërnjoftim të refugjatit. Ministria bashkëpunon me UNHCR-në në Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe vende të tjera, dhe ata na dërgojnë të dhëna për personat e repatriuar. Kosova ka një bazë të dhënash. Në bazë të dokumentacionit të këtyre personave, ata regjistrohen – Fitim merret me këtë – dhe futen në bazën e të dhënave. Në nivel komune ekziston Grupi i Punës i Komunës, të cilin sipas urdhrit e emëron kryetari i komunës. Grupi ka tetë anëtarë dhe përfshin pothuajse të gjitha drejtoritë. Dalim në terren dhe japim rekomandime, për shembull nëse asaj familjeje duhet t'i ndërtohet shtëpi apo jo. Vendimin përfundimtar e merr Ministria. Unë, si shef i zyrës, kam detyrë të mbroj vendimin e Grupit të Punës të Komunës në Prishtinë. Pra, ata marrin vendimin përfundimtar nëse do të aprovohet apo jo. Për shumë vite nuk kemi qenë pjesë e projektit RRK. Këto mjete na janë siguruar nga fondet ndërkombëtare, dhe nga viti i kaluar, ose disa vite më parë kur filloi ndërtimi i shtëpive, ne u bëmë pjesë e projektit RRK. Që atëherë, Komuna e Dragashit ka mundësinë të ndihmojë familjet që kthehen. Ne e dimë mirë se ndoshta dikush ka shkuar vetëm formalitetshëm, është regjistruar, ka marrë letërnjoftimin e refugjatit, por nuk është detyra jonë të hetojmë. Ne punojmë vetëm bazuar në dokumentacionin që marrim. E di që ka njerëz... Unë personalisht, nëse do të kisha mundësi, do t'u ndihmoja njerëzve që jetojnë këtu. Por, fatkeqësisht, kjo është politikë e Qeverisë dhe e institucioneve ndërkombëtare – të ndihmohen ata që, të paktën formal, kanë qenë të regjistruar si persona të zhvendosur. Ndoshta dikush ka shkuar për disa ditë, ka marrë dokumentin atëherë dhe tani kthehet. Ne nuk kemi mekanizma ta ndalojmë këtë. Unë do t'i hiqja i pari shtëpitë personave për të cilët janë ndërtuar, por që nuk jetojnë këtu. Por fatkeqësisht, unë nuk vendos.

Fitim Spahiu: Përsëritet për të gjithë! Fillimisht, po më vjen keq që kjo çështja e këtij plani u bë më shumë politik sesa që është në fakt. Ky plan është një plan teknokrat i cili përmban aspektin teknik të organizimit të Zyrës dhe të kthimit e riintegrit të të riatdhesuarve. Ky plan e ka bazën prej strategjisë të cilën e ka aprovue Republika e Kosovës, dhe në bazë të Rregullores në 2020-tën që është aprovue. Ka bazën e Rregullores për Integrimin e të Huajve me numër 09/2019. Çështja e procedurave se si punon zyra – Artani e ngriti – për shembull, a është punësuar dikush. Neve nuk merremi me çështjen e punësimit, me atë merret Zyra e Punësimit në Komunën e Dragashit. Ata i kanë kriteret e veta se si i punësojnë këta njerëzit. Edhe çështja e arsimit, neve nuk merremi me

çështjen e arsimit. Çështjen e arsimit e ka DKA-ja. Unë, për shembull, e kam një kontratë me Komunën e Dragashit të cilës duhet t'i përmbahem. Në kontratë thuhet se të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit që kthehen dhe regjistrohen si të riatdhesuar në Zyrën për Komunitete dhe Kthim, duhet t'u japim shërbime. Tash ai, a kthehet, a qëndron, a çon fëmijë në shkollë paralele, a çon fëmijë në shkollë të Kosovës, unë nuk jam as hetues, as polic, as prokuror, me i kontrollue. Çështja është se ky plan përmban aktivitete konkrete, teknike, se si bëhet riintegrimi i të riatdhesuarve. Janë kriteret e caktuara, një i kthyer duhet të qëndrojë minimum një vit jashtë Kosoës, dhe kur të kthehet, është obligative, në bazë të Rregullores në fjalë, dhe neve duhet t'i japim shërbim atij. Se kush është ai, se çka është ai, unë nuk jam as polic, as prokuror, thjesht jam një zyrtar i cili duhet t'i përmbahem aspektit teknik, dhe rastet referohen në ministri të caktume, apo në drejtori të caktume, për shembull, në qoftë se kemi ndonjë rast të ndonjë fëmije që don me shkue në shkollë, ne thjesht e orientojmë. Në qoftë se ka ndonjë rast që do me përfitue prej socialit, ne thjesht e orientojmë te QPS-ja. Në qoftë se ka dikush nevojë për punësim, ne e orientojmë që të shkojë në Zyrën Komunale për Punësim. Edhe një herë po ju them, ky plan është plan i Qeverisë së Kosovës, është plan gjithëkombëtar, dhe është plan specifik për Komunën e Dragashit. Mu po më vjen keq, e thashë edhe më herët, që u bë shumë politike kjo çështje, që nuk është e nevojshme për mendimin tim, së paku për këtë pikë që të diskutohet. Në qoftë se keni ndonjë çështje që ka të bëjë me këtë plan, i cili përmban dhjetë objektiva të ndryshme - besoj që e keni pas edhe e keni lexue – që ka të bëjë, për shembull, me integrimin ekonomik, social, me sistemin edukativ-arsimor, që ka të bëjë me informimin e komunitetit pritës, nëse keni rreth këtyre çështjeve mund të diskutojmë. Por, për aspektin politik unë nuk jam përgjegjës. Prandaj, të nderuar delegatë, kisha pas dëshirë nga ju që ta përkrahni këtë plan, se është plan i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe është obligim që, pas aprovimit nga ana e Kuvendit ta dërgojmë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Faleminderit!

Artan Loshaj: I nderuar Fitim, respekt! Por, unë jam i zgjedhur i popullit dhe jam pikërisht me bo politikë. Të dëgjova shumë mirë. Këtë të drejtë mos ma mohoni! Ju jeni një punëtor i cili e bëni këtë planin, edhe aty mbaron. Unë pata punë me kryetarin e Komunës edhe me shefin për Komunitete. Unë me zyrën tuaj nuk pata kurgjo edhe as nuk lypa përgjigje, as nuk lypa prej teje me u bo hetues, as prokuror, as polic. Shumë e thjeshtë është, unë nuk e di edhe pse e morre fjalën. Nuk lypi dikush prej teje sqarime. Na patëm punë, se këtu bëjmë politikë, unë e pyeta drejtorin, i thashë kryetarit qysh e lën me manipulue me këto. Thjesht! Përgjigje prej punëtorëve të Komunës – unë kam respekt shumë për ty, na jemi bashkëvendas këtu – nuk lypa llogari, nuk lypa me u bo prokuror, nuk lypa me u bo polic, nuk lypa sqarime. Ti këtë ia përpilosh kryetarit ose kënd e kie shef, Uzairin, edhe qaty mbaron. Unë jam punëtor shëndetësor, atje jam nën urdhërat e doktorit edhe të drejtorit. Unë s'un i marr kompetencat e drejtorit me ardhë me diskutue këtu. Tjera herë, kryesues, bëjmë politikë, sqarime japin kryetari, drejtori, shefat, kemi plot për sqarime, masnej këta tjerit.

Granit Rifaj: Përsëritet! Me gjithë respektin për ty, unë jam i kënaqur edhe për mu je person i respektuar, e bëjsh punën tënde edhe nuk pata kurgjo me ty. Dashta me e pyet shefin e Zyrës, edhe atë nuk dashta me e akuzue kryetarin, po me e pyet, se qysh po e shohim na është riintegrim i

qëndrueshëm i personave të riatdhesuar. Në qoftë se është riintegrim, a duhet me u integruë në institucionet e shtetit? A juve nuk po ju interesojka a e vazhdon në institucione paralele shkollimin ose çka bën. Edhe përzgjedhjen e lypëm me e pa, qysh bëhet përzgjedhja. Tash unë nuk po due me hy me bo politikë e propaganda, jo grue e ish-policit, jo a kanë fitue azil kundër UÇK-së. Veç kriteret me na i kallxue. Edhe, riintegrim i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar, a quhet kur të shkojnë në shkollë në institucione paralele. Kaq, nuk e kemi personale me asnjërin këtu edhe shumica e këtyre nuk janë në përgjegjësi të juajën. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Artan, keni të drejtë që pushteti ekzekutiv as vullneti i zyrtarëve nuk mund të ndikojnë këtu. Por pas gjithë këtij shpjegimi, është plotësisht e qartë ajo që thashë në fillim: ky është një dokument qeveritar. Prandaj, po pyes kryetarin e komunës, presidentin e Dragashit — cilat janë obligimet e Komunës së Dragashit sipas këtij dokumenti? A do të kemi në buxhet disa shpenzime si komunë? Duke qenë se kjo është një plan, dhe ne nuk shohim buxhetin, a është vetëm një plan qeveritar që komunat duhet ta miratojnë dhe që lidhen me këtë fushë, apo ky plan sjell edhe detyrime buxhetore? Kjo është një pyetje. Readmisioni ekziston edhe në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi. I gjithë Ballkani ka pasur ikje, dhe të gjithë po kthehen — në Bosnje nuk flasim, Shqipëria është një tjetër histori, atje nuk ka, por Readmisioni ekziston kudo. Ju keni të drejtë, Readmisioni është i plotë. Nxjerr kartën e identitetit, paguan taksat në këtë shtet, kthehesh dhe jeton si të duash. Regjistrohesh në shkollë, regjistrohesh tek mjeku që ke zgjedhur dhe bëhesh një “kosovar i rregullt”. Ky është “ik dhe vij”, nuk duhet të gënjejme veten. Kryetari i komunës, edhe një herë i kërkoj falje, duhej vetëm të na thoshte se ky është një dokument qeveritar, që duhet ta miratojmë, që ka të bëjë me Readmisionin dhe të ngjashme. Dhe sigurisht ne do të votonim. Duhet të votojmë sepse duhet ta mbështesim — kërkon Qeveria, kërkon shteti, dhe duhet të veprojmë sipas këtyre rregullave. Por sjellja, zotëri... le të shërbejë si mësim.

Fitim Spahiu: Dashta me iu përgjigj Baldzit unë. Edhe Artanit, ër shembull, Artani pyeti sa janë të punësuar, sa kemi në arsim e sa kemi në shëndetësi. Edhe një herë po e sqaroj, nuk merremi ne me punësimin, ose me arsimin, thjesht janë drejtoritë e caktuara që merren me këtë. Ndërsa, sa i përket Baldzit, te buxheti, ky nuk ka implikime buxhetore në Komunë, për shkak se buxhetin e menaxhon Ministria e Punëve të Brendshme – Sektori për Riatdhesim – dhe kërkesat tona që aprovohen prej komisionit, shkojnë në Ministri dhe ata në mënyrë automatike i financojnë.

Resul Fetahu: Faleminderit! Nëse nuk ka të tjerë që dojnë me e marrë fjalën, e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 18 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e shtatë: Propozimi i dy delegatëve të Kuvendit të Komunës së Dragashit për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës. A dëshiron dikush me e marrë fjalën? Atëherë ftojme partitë që të japin emrat e propozuar, pastaj diskutojmë!

Vezir Reshiti: Nga LDK propozojmë Shukri Myrtezanin!

Granit Rifaj: Në emër të GP të PDK-së, z.Zgjim Fejza!

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, emrat që janë të propozuar për delegatë në Kuvendin e AKK-së, janë: kryetari i Komunës, z.Bexhet Xheladini, Shukri Myrtezani dhe Zgjim Fejza. A do dikush me e marrë fjalën?

Usmen Baldzi: Ka kaluar thuajse disa muaj, disa ditë nga formimi i pushtetit pas zgjedhjeve lokale në Kosovë, dhe jemi dëshmitarë se pothuajse të dhjetë komunat serbe në Kosovë janë larguar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Ndoshta e keni dëgjuar dhe nuk duan të jenë pjesë e Asociacionit të Komunave të Kosovës, gjë që është shumë keq për Kosovën dhe për të gjithë ata që duan Kosovën dhe që duan ta bëjnë Kosovën një shtet të fortë, funksional, demokratik dhe evropian. Megjithatë, kemi edhe gjëra të tilla. Ndoshta e keni dëgjuar, nëse jo, le t'ju informoj. Propozuesi në këtë rast, zotëri kryetari i komunës, ndoshta ka kontaktuar Asociacionin e Komunave të Kosovës si asocacionin kryesor në Kosovë, ku të gjithë jemi anëtarë që nga themelimi, dhe kjo është e mirë. Por duhet, pra, t'ju lus, të bëj apel, të ndikoj te pushteti dhe opozita për të propozuar diçka. Kam lexuar statutën e komunës dhe nuk flet asgjë për numrin e anëtarëve dhe strukturën. Kam lexuar gjithashtu ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe as aty nuk parashikohet që numri i anëtarëve të përcaktohet. Nuk kemi një rregull pse tre, pse nuk mund pesë, nuk ka një gjë të tillë. Kam biseduar edhe me kryetarin e komunës, të jem i sinqertë, dhe ai më tha se sipas asaj që i është thënë nga Prishtina duhet të jenë tre. Dhe gjithçka të marrim si e saktë, unë do të propozoja vetëm një plotësim të kësaj vendimi. Të vihet në votim. Të ketë dikush nga komuniteti jo-shumicë në këtë delegacion, që më saktë Gora të përfaqësohet në Asociacionin e Komunave të Kosovës. Dhe që anëtari të jetë dikush nga ne katër që i përshtatet.

Resul Fetahu: Kjo është më Statut të Komunës, në Nenin 32 shkruan. Është edhe prej Asociacionit të Komunave e përcaktuar me ligj. Ata kështu e kanë kërkuar dhe kështu i kemi propozuar. Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, mu para disa dite më ka ardhë shkresa prej Asociacionit të Komunave, dhe këtu shkruan që për çdo dhjetë anëtar të Asamblesë propozohet nga një delegat. Duke marrë parasysh se ne i kemi 21, neve na takon dy, edhe është thënë që një prej PDK-së dhe një prej LDK-së. Ndërsa, sa i përket përfaqësimit të komuniteteve joshumicë, është një rregull tjetër, ku AKK-ja, në bazë të një marrëveshjeje e përcakton formulën e përfaqësimit të minoriteteve. Sigurisht se ata kanë marrë qëndrim, ndoshta nga Mamusha, nga Prizreni, ose nga ndonjë komunë tjerë, ta përfaqësojnë Asociacionin me delegatë. Kjo nuk është çështje e imja, unë jam bazuar në bazë të shkresës që e kam marrë nga AKK-ja. Në takimin e parë, kur të zgjidhet kryetari i Asociacionit, unë do ta bëj një bisedë me të, edhe do ta shohim a ka mundësi Komuna e Dragashit të përfshihet edhe me një delegat. Siç e dish, herën e kaluar kemi pas, por i kemi pas 27 delegatë. Tash i kemi 21, na është zvogëluar edhe numri i delegatëve. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Është e qartë letra juaj që keni marrë. Do të ishte mirë që pas miratimit të këtij Vendimi të shtojmë, për faktin se komuna e Dragashit është specifike, ka dy rajone dhe 39% komunitete jo-shumicë, nuk është si Prizreni... 1%, 5%, ne jemi të tjerë. Kjo duhet të thuhet, dhe

më pas të theksohet se duhet të kemi edhe një anëtar nga Gora, që Gora të përfaqësohet në Asociacionin e Komunave të Kosovës. Nuk do të them pse, sepse ndoshta më kuptoni.

Resul Fetahu: Faleminderit! A do diksuh tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 17 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën eventuale. Kush do me e marrë fjalën në pikën eventuale? Nëse nuk ka, atëherë e mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancat e tjera! Faleminderit!